

Sektori i shërbimit social

Përgjegjës sektori.

Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social është nëpunës civil dhe ushtron funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë që burojnë nga ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, legjislacionit specifik të fushës së veprimtarisë. 6. Detyrat 1. Të organizojë dhe administrojë punën në sektor të informojë mbi situatën social-ekonomike për target grupet në nevojë të bashkërendojë punën me OJF-te.

2. Merr masa organizative për plotesimin e detyrave të punonjësve në veçanti dhe si sektor brenda planifikimit të detyrave organizon sistemimin e informacionit dhe të statistikave për veprimtarinë e sektorit.

3. Përgatit projekt-vendimin e dërgimit në institucionet rezidenciale të shërbimit social personave të cilët paraqesin kërkesën pranë këtij seksioni.

4. Evidenton problemet që dalin nga veprimtaria e përditëshme dhe i propozon drejtorit rrugë zgjidhje të ndryshme. 45.2

Specialist i Ndhmës Ekonomike (i) Misioni Eshtë nëpunës civil në varësi të Përgjegjësit të Sektorit shërbimit Sociale. (ii) Detyrat

1. Të identifikojë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike;

2. Të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike, të familjeve në nevojë kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike;

3. Të hartojë listen me familjet në nevojë për të përfituar ndihmë ekonomike e cila do të propozohet për miratim në Këshillin Bashkiak;

4. Të ndihmojë në përgatitjen e dokumentacionit, për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike;

5. Të marrë pjesë në procesin e hartimit të projektvendimit për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike;

6. Të llogarisë dhe të propozojë për miratim, në sektorin e mirëqenies dhe kujdesit social, masën e ndihmës ekonomike;

7. Të hartojë kërkesën për bllok-ndihmë për çdo dymujor ;

8. Të bashkëpunojë për hartimin e planeve vendore në mbështetje të personave në nevojë;

9. Të vlerësojë nevojat e individëve apo familjeve që kërkojnë të marrin ndihme ekonomike në përputhje me prioritetet e Bashkisë Prrenjas, mundësitë financiare për mbulimin e këtyre shërbimeve, përgatit dokumentacionin dhe propozimet për aprovim në Këshillin e Bashkisë ;

10. Të grumbullojë dhe të hartojë informacione, statistika, dhe të mbajë regjistrin e përfituesve, dhe të ndjeke shpenzimet për ndihmën ekonomike;

11. Të grumbullojë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e Bashkisë;

12. Kryen cdo detyrë tjetër me urdhër të eprorit.

Specialist i personave me aftësi të kufizuar Specialisti i personave me aftësi të kufizuar është nëpunës civil në varësi të drejtpërdrejtë të Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimit Social dhe ushtron detyrat e mëposhtme:

1. Përgatitja e relacioneve dhe projekt vendimeve për miratim në Këshillin Bashkiak të bllok ndihmës dhe vënia në dijeni të tij për përfituesit e P.A.K. verbërit , para dhe tetraplegjikët dhe përfituesit e shtesës së invaliditetit.

2. Përpilimi i evidencave statistikore në kohë dhe dërgimi i tyre në drejtorinë rajonale të shërbimit social shtetëror.

3. Përpilimi i listave të përfituesve të ndihmës ekonomike të P.A.K verbërve para tetraplegjikëve dhe invaliditetit sipas ligjit dhe duke respektuar fondin e ardhur nga buxheti i shtetit. (Borderotë)

4. Krijon dhe menaxhon dosjet e personave që kalojnë në KEMP të cilat dorezohen dhe merren me procesverbal

5. Pranon librezat e të verbërve dhe paraplegjikeve.

6. Pranon dokumentacionin e pagesës së invalideve,dosjet e të cileve mbahen në zyrë.

7. Mban dokumentacionin e nevojshëm bazuar në ligj për personat që përfitojnë nga Statusi i verbërise dhe të paraplegjikëve.

8. Përgatit projekt-vendimet për personat e verbër, kujdestarët e tyre, paraplegjikët dhe Kujdestarët e paraplegjikëve.

9. Kryen edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga përgjegjësi i sektorit.

Specialist për problemet e dhunës në familje dhe barazisë gjinore (i) Misioni Specialisti për dhunën në familje dhe barazinë gjinore është punonjës i cili ka epror direkt Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimit Social. (ii) Detyrat

1. Identifikimi i problematikës në familje në territorin e Bashkisë Prrenjas, duke bërë monitorimin e rasteve të dhunës në familje.
2. Ai/ajo asiston në të gjitha seancat gjyqësore që lidhen me këto problematika, duke realizuar hedhjen e të dhënave në sistemin databazë.
3. Bën sensibilizim dhe ndërgjegjësim të komunitetit për fenomenin e dhunës në familje dhe barazisë gjinore.
4. Mund të kërkojë ngritjen e kërkesë-padisë në lidhje me kërkesën për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje me pëlqimin e viktimës.

Specialistë për mbrojtjen e fëmijëve (i) Detyrat dhe Përgjegjësitë

1. Specialist për mbrojtjen e fëmijëve të identifikojë rastet e fëmijëve me probleme si rrezik trafikimi, abuzim fizik, emocional, shfrytëzim për lypje e punë të zezë.
2. Të indentifikojë fëmijët që iu shkelen të drejtat e tyre rast pas rasti.
3. Të bashkëpunojë me psikologët e shkollave, policinë dhe OJF të ndryshme që kanë në studimkëto problematika.
4. Të japë asistencë profesionale ndaj këtyre fëmijeve që mbartin këto probleme.
5. Të japë zgjidhje në rrjetin e shërbimeve publike dhe private në territorin e Bashkisë.